



NJOFTIM PËR KONTRATË

Shërbim

Procedurë e hapur

*Në përputhje me Nenin 6 të Rregullës së Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
(Shtator 2021)*

Data: 03.05.2024

Nr. i Prokurimit: BQK 24 031 211

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: ‘‘Shërbime të mirëmbajtjes vjetore të Oracle Flexcube’’
Lloji i prokurimit: Shërbim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë : Po
Variantet pranohen: JO
Vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00 Euro
Ndarja në Pjesë (lote): JO

III INFORMACIONE PËR SHËRBIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale mirëmbajtjen vjetore të sistemit “Oracle” Flexcube, sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t’u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

IV KRITERET E PËRZGJEDHJES¹/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t’i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri sipas kriterëve të përzgjedhjes të specifikuar këtu në vijim:

<p>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2, 3) është e obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</p>	<p><u>Kërkesa 1:</u> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.</p>
	<p><u>Evidenca 1:</u> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në “Aneksin 3” të dosjes së tenderit.</p>
	<p><u>Kërkesa 2:</u> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C, përfshirë “Deklaratën e ofertuesve”</p>
	<p><u>Evidenca 2:</u> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në pikat 1, 2 dhe 3.</p>
	<p><u>Kërkesa 3:</u> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium)</p>
	<p><u>Evidenca 3:</u> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i ofertuesve, nga grupi kërkohet që së bashku me tenderin të dorëzojnë edhe marrëveshjen e nënshkruar në origjinal për krijimin e grupit. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm para ofertuesit për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i ipet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Në marrëveshjen e grupit kërkohet të specifikohet lideri i grupit.</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të</i></p>	<p><u>Kërkesa 4:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p>

¹ Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

<p><i>dokumenteve (kërkesat nga 4 deri në 9) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p>Evidenca 4: Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p>Kërkesa 5: Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p>Evidenca 5: Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p>Kërkesa 6: Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p>Evidenca 6: Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5, dhe 6.</p>
<p>Kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe/ose profesional</p>	<p>Kërkesa 7: Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë të natyrës së ngjashme përgjatë 3 (tri) viteve të fundit (2021, 2022 dhe 2023, përfshirë edhe 2024 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë).</p> <p>Evidenca 7: Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi:</p> <p>a) certifikatat relevante të pranimit të shërbimit ose referencat që evidencojnë realizimin e shërbimit të tillë dhe</p> <p>b) kopjet e kontratave përkatëse.</p> <p>Kërkesa 8: Ofertuesi duhet ta plotësojë formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p>Evidenca 8: Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me shërbimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit (2021, 2022 dhe 2023, përfshirë edhe 2024 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë) duke saktësuar shërbimet e realizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej shërbimeve;</p> <p>Kërkesa 9: Ofertuesi duhet të ofrojë autorizimin nga Oracle.</p> <p>Evidenca 9: Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi autorizimin nga kompania Oracle për mirëmbajtjen vjetore të sistemit Flexcube.</p>
<p>Inspektimi i kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale</p>	<p>Banka Qendrore, me shpenzimet e saj, mund të kryejë një inspektim të operatorëve ekonomik tenderues për qëllime të verifikimit të kapaciteteve disponuese të tyre për vërtetimin e cilësisë, punën e tyre në vend sipas referencave, mjetet për transport dhe çdo informatë tjetër të nevojshme që mund të dëshmojë që ofertuesi mund ta realizojë kontratën.</p>

V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: E hapur

VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të ulët.

VII INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit 10.05.2024, ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 10.05.2024, ora 14:00
Dokumentet me pagesë: Jo
Siguria e tenderit: 5,000.00 € (pesë mijë euro) për periudhë valide prej 90 dite.
Sigurimi i kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e hapjes së ofertave
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave: 14.05.2024, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave: 14.05.2024, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr.“Garibaldi” nr.33, Prishtinë.

VIII INFORMATA PLOTËSUESE

VIII.1 ANULIMI I PROCEDURES SE PROKURIMIT

Në përputhje me Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht Neni 40 “Anulimi i procedurave të Prokurimit”, Banka Qendrore mund të anulojë procedurën e prokurimit në çdo kohë para nënshkrimit të kontratës, duke mos iu dhënë të drejtë kandidatëve apo tenderuesve që të kërkojnë ndonjë kompensim.

VIII.2 ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (shtator 2021)”, respektivisht sipas Neni 41 të këtyre Rregullave, “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së.

IX. ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni I Prokurimeve	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/451	Fax: 038 243 763